



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve  
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije  
National Qualification Authority

Numër: 01/404

Datë: 20.08.2021

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe, Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35-2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 20.08.2021 nxjerrë këtë:

### V E N D I M

1. **Akreditohet** "Instituti Profesional ATC", me adresë Rr. Rr. "Bedri Pejani", Prishtinë, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 20.08.2021 deri 19.08.2024, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

**1.1 AUTOMEKANIK**, Niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 21 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga tetë (8) kandidat brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në gjashtë (6) grupe.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së "Instituti Profesional ATC", për validim, akreditim dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimit, si dhe Raporti i ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos **si në dispozitiv të këtij vendimi.**

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të

kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.


Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. "Instituti Profesional ATC", dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

  
Kryetar KD së AKK